

## RELACION

### PËR PROJEKTVENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE

#### “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 111, DATË 23.2.2018, “PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E FONDIT SOCIAL”

#### **I.QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Projektvendimi “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 111, datë 23.2.2018, “Për krijimin dhe funksionimin e fondit social”, propozohet nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Ministrin e Financave dhe Ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor.

Qëllimi i këtij projektvendimi është garantimi i ngritjes së mekanizmit financiar të Fondit Social, si një mekanizëm aktiv dhe efektiv në të gjitha Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVQV).

Projektakti i propozuar është rezultat i një vlerësimi të thelluar paraparak të ndërmarrë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale lidhur me kuadrin ligjor dhe funksionimin e Fondit Social në juridiksionin vendor. Ligji nr.121/2016 krijon vetëm kornizën ligjore për krijimin e Fondit Social, duke ia deleguar Këshillit të Ministrave (KM) dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) nxjerrjen e akteve nënligjore për ngritjen, funksionimin dhe administrimin e Fondit Social. Bazuar në Nenin 47/4 të ligjit nr.121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” ( në vazhdim ligji nr.121/2016), për ngritjen e Fondit Social, Këshilli i Ministrave miratoi Vendimin nr.111/2018, “Për krijimin dhe funksionimin e Fondit Social”, i cili parashikonte se Fondi Social krijohet si një mekanizëm financiar nëpërmjet të cilit sigurohet mbështetje financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore, për arritjen e qëllimeve të parashikuara në Nenin 47/1, të ligjit nr.121/2016. Megjithatë ajo që është evidentuar nga analiza e bërë në nivel të NJVQV është fakti se në asnjë prej bashkive të analizuara nuk është ngritur ky mekanizëm financiar në nivel vendor, për shkak të vakumit ligjor lidhur me mungesën e parashikimeve specifike, që do të mundësonin ngritjen e Fondit Social në nivel të NJVQV-re në përputhje me parashikimet e ligjit nr.121/2016. Pikërisht me qëllim për të mundësuar efektivisht ngritjen e Fondit Social në nivel vendor, propozimet parashikojnë krijimin e Fondit Social, si program buxhetor më vete në çdo Njësi të Vetëqeverisjes Vendore sipas një kodifikimi të përcaktuar në buxhetin vendor.



Në këtë kuptim, mekanizmi financiar i Fondit Social do të lehtësonte ndërveprimin dhe mbështjetjen financiare nga pushteti qendror, tek pushteti vendor, me qëllim përmirësimin e standardeve dhe kapaciteteve administruese të shërbimeve ekzistuese të kujdesit shoqëror, ngritjen e shërbimeve të reja të kujdesit shoqëror dhe zhvillimin e politikave sociale në nivel vendor.

## **II.VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Ky projektvendim është rezultat i analizës së thelluar paraprake të kryer nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale lidhur me kuadrin ligjor dhe sfidat e funksionimit të Fondit Social në juridiksion vendor. Si i tillë, ai është propozuar bazuar në rekomandimet e nxjerra nga MSHMS në vijim të kësaj analize të thelluar.

Projektvendimi nuk është pjesë e Programin të Përgjithshëm Analitik të Projektakteve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Financave që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2024.

## **III.ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Fillesat për nocionin e krijimit të një fondi social në ndihmë të bashkive për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror për kategoritë vulnerabël datojnë nga 2005. Megjithatë, vetëm në 2016, Ligji nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, parashikoi në mënyrë të posaçme në nenin 47 të tij se: “*Bashkia, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale, krijon dhe administron fondin social, nëpërmjet të cilit sigurohet mbështetje financiare për njësitë e qeverisjes vendore*”. Sipas këtij neni Fondi Social ka si qëllim përmirësimin e standardeve e të kapaciteteve administruese të shërbimeve ekzistuese të kujdesit shoqëror, krijimin e shërbimeve të reja dhe zhvillimin e politikave sociale.

Bazuar në pikën 2, të Nenit 47, Fondi social përbëhet nga: *a) të ardhurat vjetore nga Buxheti i Shtetit; b) financime jashtëbuxhetore nga organizata vendase apo të huaja ose persona të tjerë; c) të ardhurat nga zbatimi i tarifave për shërbime të ndryshme të kujdesit shoqëror; ç) të ardhurat nga burimet e veta dhe nga pasuritë që zotëron ministria përgjegjëse për çështjet sociale; d) të ardhurat nga burimet e veta dhe nga pasuritë që zotëron bashkia*. Në kuptim të këtij neni, Ministria përgjegjëse për çështjet sociale parashikon si pjesë të buxhetit të vetë vjetor fonde për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat u transferohen njësisë të qeverisjes vendore, ku funksionojnë këto shërbime të kujdesit shoqëror.

---

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 111, datë 23.2.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe funksionimin e fondit social”.



Megjithatë, deri më sot, mbështetja financiare nga MSHMS drejt Bashkive në kuadër të Fondit Social transferohej përmes programeve buxhetore që NJVQV kishin në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror, duke mos pasur një program buxhetor të dedikuar për Fondin Social, i cili jo vetëm do të lehtësonte procedurat e realizimit të mbështetjes financiare nga pushteti qendror drejt pushtetit vendor, por gjithashtu do të mundësonte krijimin e Fondit Social Vendor konform parashikimeve të nenit 47, të ligjit nr.121/2016.

Në këtë kuptim, Njësia e vetëqeverisjes vendore pas vlerësimit të nevojave për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel vendor dhe hartimit të planin social vendor do të ketë mundësi të identifikojë ato shërbime që mbeten të pafinancuara bazuar në programin buxhetor afatmesëm. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale do të parashikojë në buxhetin e saj fonde për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat bazuar në draftvendimin e propozuar do t'u transferohen Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, ku funksionojnë këto shërbime si pjesë e programit buxhetor të Fondit Social në nivel vendor.

Për sa më sipër, miratimi i ndryshimeve të propozuara do të synojë:

- ngritjen dhe funksionimin efektiv të fondit social në nivel vendor duke iu krijuar mundësinë NJVQV për të administruar fondet e transferuara në programin e Fondit Social për realizimin e produkteve dhe shërbimeve të planifikuara prej tyre në periudha 3 vjeçare.
- mundësinë e planifikimit më të mirë buxhetor në nivel vendor të fondeve vendore për efekt të Fondit Social, gjë që do të garantonte më shumë mbështetje për ngritjen e shërbimeve të reja dhe përmirësim të atyre ekzistuese me fonde si nga financat vendore, ashtu edhe nga pushteti qendror.
- administrimin dhe monitorimin më të mirë të financave të vetëqeverisjes vendore në drejtim të shërbimeve të kujdesit shoqëror.
- garantimin e qëndrueshmërisë së shërbimeve të ngritura me mbështjetjen financiare të pushtetit qendror, përmes parashikimit të shpenzimeve buxhetore të dedikuara nga buxheti i Bashkive për vazhdueshmërinë e ofrimit të shërbimeve të ngritura në nivel bashkie.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Ky projektvendim është hartuar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 24, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar dhe të pikës 4, të nenit 47, të ligjit nr. 121/2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror".

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS TË BE-SË**

Ky projektvendim nuk synon të përafrojë legjislacionin shqiptar me ACQUIS të BE-së.

## **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Në Vendimin Nr.111, datë 23.2.2018, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1 parashikohet që pas pikës 1, shtohet pika 1,1 me këtë përmbajtje:

*“1.1 Fondi Social krijohet si program buxhetor më vete në çdo Njësi të Vetëqeverisjes Vendore sipas një kodifikimi të përcaktuar në buxhetin vendor. Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore përcaktojnë produktet buxhetore brenda programit të Fondit Social bazuar në qëllimin e funksionimit të tij në nivel vendor.”*

2.Në pikën 2, shkronja “b” , ndryshohet si më poshtë vijon:

*“b. fondet nga buxhetet e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, të parashikuara në programin e buxhetit të Fondit Social”.*

3.Pikat 4.1 dhe 4.3, ndryshohen si më poshtë vijon:

*“4.1 Njësia e vetëqeverisjes vendore vlerëson nevojat për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel vendor dhe harton planin social vendor duke identifikuar ato shërbime që mbeten të pafinancuara bazuar në programin buxhetor afatmesëm.”*

*4.3 Ministria përgjegjëse për çështjet sociale parashikon në buxhetin e saj fonde për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat u transferohen njësive të vetëqeverisjes vendore, ku funksionojnë këto shërbime si pjesë e programit të Fondit Social në nivel vendor. Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore administrojnë fondet e transferuara në programin e Fondit Social për realizimin e produkteve dhe shërbimeve të planifikuara prej tyre në periudha 3 vjeçare.”*

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHET PËR ZBATIMIN E AKTIT**

Për zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohen Ministria përgjegjëse për çështjet sociale, Ministria përgjegjëse për pushtetin vendor dhe Ministria përgjegjëse për financat.

## **VIII.PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKAKTIT**

Për hartimin e këtij projektvendimi kanë kontribuar strukturat përkatëse të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Ministrisë së Financave dhe Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor .

Projektvendimi është hartuar dhe koordinuar nga MSHMS përmes grupit ndërinstitucional të punës të ngritur me Urdhër të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr.502, datë

---

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 111, datë 23.2.2018, të Këshillit të Ministrave. “Për krijimin dhe funksionimin e fondit social”.



21.08.2023, "Për ngritjen e grupit të punës për rishikimin e kuadrit ligjor mbi funksionimin e mekanizmit të fondit social".

Projektvendimi do të dërgohet për konsultim të brendshëm në Ministrinë e Drejtësisë dhe Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

## **IX.RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Ky vendim nuk shoqërohet me efekte financiare për buxhetin e shtetit.

### **PROPOZUESIT**

**MINISTRI I FINANCAVE**

**Ervin METE**

**MINISTRI I SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE**

**Albana KOCIU**

**MINISTRI I SHTETIT PËR  
PUSHTETIN VENDOR**

**Arbjan MAZNIKU**